

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA SAMIR AVDIAJ

**KOMPETENCAT E MËSIMDHËNËSVE TË
GJUHËS SHQIPE NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR LIDHUR ME NORMËN
E SHKRUAR**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2024

UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”

FACULTY OF PHILOLOGY



MA SAMIR AVDIAJ

**THE COMPETENCIES OF ALBANIAN
LANGUAGE TEACHERS IN PRE-
UNIVERSITY EDUCATION
REGARDING THE WRITTEN
STANDARD**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2024

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA SAMIR AVDIAJ

**KOMPETENCAT E MËSIMDHËNËSVE TË
GJUHËS SHQIPE NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR LIDHUR ME NORMËN E
SHKRUAR**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentorët:

Prof. dr. Rrahman Paçarizi

Prof. dr. Atdhe Hykolli

Prishtinë, 2024

PËRMBLEDHJE

Interesi për studimin e shqipes së shkruar ka nisur që në gramatikën e parë të autorëve të huaj, si Da Leçe, i cili, në librin e tij "*Vërejtje gramatikore mbi gjuhën shqipe dhe ortografinë e saj*" (1716) ai trajton normën e shkruar të shqipes dhe propozon korrigjime për gabimet e shtypit. Ky zhvillim ka vazhduar dhe është pasuar nga punime të tjera si "*Rregulla gramatikore të gjuhës shqipe*" e Francesco Rosit dhe broshura "*Oroe permii abetare shqyp*" e Shoqërisë Bashkimi (Kastrati, 1955), kjo e fundit është e para që ka hedhur hapat në historinë e drejtshkrimit të shqipes, duke vendosur rregulla për përdorimin e zanores "ë" në gjuhën e shkruar. Puna e këtyre autorëve ka krijuar një bazë të rëndësishme për formimin e standardit të shqipes.

Pas këtij zhvillimi teorik, kemi vlerësuar se është e nevojshme të hulumtohet implementimi i këtyre rregullave dhe performanca e mësimit të Gjuhës shqipe sa i përket kompetencës drejtshkrimore, duke e konsideruar këtë grup të mësimit si faktorin kryesor në bartjen e këtij standardi. Mësimdhënësit janë ata që përçojnë njohuritë drejtshkrimore të nxënësit dhe, për këtë arsye, është e rëndësishme të vlerësohet sa ata janë të aftë të përvetësojnë dhe të aplikojnë këto rregulla në praktikë dhe sidomos gjatë punës me nxënësit.

Filozofia mbi të cilën ndërtohen metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, e mbështetur në idenë se nxënësit mësojnë më mirë duke vepruar, thekson rëndësinë e angazhimit aktiv të nxënësve dhe mësimit si partnerë në procesin e nxënies. Zhvillimi i kompetencës drejtshkrimore është një proces i vazhdueshëm që kërkon praktika të rregullta dhe reflektim të qëndrueshëm, ku shkrimi luan një rol kyç. Shkrimi është një mjet i fuqishëm për forcimin e aftësive drejtshkrimore, pasi nxit reflektimin dhe vetëkorrigjimin e gabimeve. Në këtë kontekst, është e nevojshme të shqyrtohet sa mësimit janë të aftë të udhëheqin nxënësit në përvetësimin e një norme të saktë dhe të qëndrueshme.

Punimi ynë me titull "*Kompetencat e mësimit të Gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar lidhur me normën e shkruar*" përbëhet nga gjashtë kapituj.

Kapitulli i parë ofron një hyrje të përgjithshme në temën e studimit, duke paraqitur problemin e hulumtimit, qëllimin, pyetjet kërkimore, hipotezat, rëndësinë e hulumtimit dhe konceptet

themelore të studimit. Ky kapitull është një pasqyrë e gjithë punës kërkimore, duke e vendosur studimin në kontekstin e rëndësisë që ka kompetenca drejtshkrimore e mësimdhënësve të Gjuhës shqipe dhe procesin e mësimdhënies së normës së shkruar. Përmes këtij kapitulli përcaktohet qartazi drejtimi i hulumtimit dhe synimi për të analizuar performancën e mësimdhënësve në përvetësimin dhe përdorimin e rregullave drejtshkrimore, si dhe ndikimi i praktikave të mësimdhënies në zhvillimin e këtyre aftësive tek nxënësit.

Kapitulli i dytë ka karakter përshkruar dhe ofron një pasqyrë historike mbi zhvillimin e gramatikave shkollore të shqipes nga viti 1635 deri në vitin 1912. Në këtë kapitull pasqyrohet kontributi i autorëve të huaj dhe vendorë në hartimin e gramatikave shkollore të shqipes, duke nisur me Fjalorin *latinisht-shqip* të Bardhit (1635), si një nga burimet e para të kësaj natyre.

Përveç gramatikave të autorëve të huaj, në këtë kapitull theksohet edhe roli i rilindësve shqiptarë, të cilët kontribuan në zhvillimin e gramatikave shkollore të shqipes, duke përfshirë veprat e tyre që ndihmuan në sistematizimin dhe organizimin e gjuhës shqipe, duke e përmbyllur historinë e gramatikave shqipe me kontributin e Luigj Gurakuqit, veprat e të cilit janë një vazhdim i natyrshëm i këtyre përpjekjeve, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e gramatikës shkollore të shqipes për shkolla të mesme.

Kapitulli i tretë fokusohet në trajtimin e Gjuhës shqipe si lëndë mësimore në kurrikula dhe tekste shkollore gjatë periudhës 1915-2020. Në këtë kapitull shqyrtohet përmbajtja dhe struktura e gramatikave shkollore të cilat përdoren aktualisht sipas kurrikulës (MASHT, 2011), hapësira që ka zënë norma e shkruar në librat dhe fletoret e punës të Gjuhës shqipes, duke theksuar se ato kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e aftësive gjuhësore të nxënësve. Përfshirja e rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore në këto tekste ndihmon në formimin e njohurive të strukturuar dhe të qëndrueshme të gjuhës shqipe për nxënësit.

Kapitulli i katërt ofron një vështrim të detajuar mbi praktikën e mësimdhënies dhe mënyrën se si norma e shqipes së shkruar mësohet dhe aplikohet në arsimin parauniversitar në Kosovë. Fokusimi është në metodat dhe teknikat që përdoren nga mësimdhënësit për të ndihmuar nxënësit t'i përvetësojnë rregullat drejtshkrimore dhe të krijojnë njohuri të qëndrueshme dhe të sakta të gjuhës shqipe.

Një ndër praktikat më të shpeshta dhe efektive konsiderohet shkrimi i esesë si pjesë e vlerësimit me notë. Eseja konsiderohet si mjet i rëndësishëm për zhvillimin e aftësive të shkrimit dhe për forcimin e kompetencës drejtshkrimore të nxënësve. Në këtë kapitull shqyrtohet organizimi i këtij aktiviteti, duke përfshirë aspekte, si: numrin e orëve, objektivat mësimore, kriteret e vlerësimit, mënyrat e korrigjimit dhe informatat kthyesë që mësimdhënësit ofrojnë për nxënësit, të cilat janë thelbësore për reflektimin dhe përmirësimin e aftësive të tyre të shkrimit.

Kapitulli i pestë analizon shkeljet më të shpeshta drejtshkrimore të mësimdhënësve të Gjuhës shqipe, duke shqyrtuar edhe shkaktarët që ndikojnë në (mos)zotërimin e normës drejtshkrimore. Fokusimi është në identifikimin e gabimeve drejtshkrimore që ndodhin gjatë procesit të shkrimit dhe se si këto shkelje mund të lidhen me mungesën e njohurive të rregullave drejtshkrimore të shqipes. Gjithashtu, ky kapitull trajton ndikimin e faktorëve tjerë, konkretisht përgatitjes profesionale, çështje lidhur me standardin e shqipes që mund të jenë shkaktarë të moszbatimit të plotë të normës drejtshkrimore.

Kapitulli gjashtë analizon një tjetër aspekt të rëndësishëm siç është vetefikasiteti i mësimdhënësve të Gjuhës shqipe, veçanërisht lidhur me përgatitjen e testeve (vlerësimeve) me shkrim. Këtu do të pasqyrohet se sa janë efikasë mësimdhënësit e Gjuhës shqipe në krijimin e testeve me shkrim përmes të cilëve kontrollohen njohuritë e nxënësve dhe nëse mësimdhënësit janë të aftë të aplikojnë një metodologji të mirëfilltë dhe të saktë për vlerësimin e aftësive të shkrimit, sidomos në stimulimin e mendimit kritik.

Korpusi i këtij hulumtimi përfshin 110 shkolla të ndryshme të Republikës së Kosovës. Në hulumtim janë përfshirë të gjitha rajonet e Kosovës, dhe për shkak të natyrës se hulumtimit, numri i shkollave nuk është përcaktuar në përputhje me përfaqësimin e secilës zonë. Pjesë e këtij hulumtimi janë 72 shkolla fillore dhe 38 shkolla të mesme. Nga këto, 38 shkolla janë të vendosura në zona rurale dhe 72 në zona urbane.

Për më tepër, nga Rajoni i Prishtinës janë përfshirë 30 shkolla, nga rajoni i Mitrovicës 9 shkolla, nga Rajoni i Pejës 20 shkolla, nga Rajoni i Prizrenit 16 shkolla, Gjilanit dhe Ferizajit me nga 5 shkolla dhe Rajoni i Gjakovës me 25 shkolla.

Paraprakisht kemi kërkuar pëlqim me shkrim nga drejtoritë komunale të arsimit, me qëllim të lehtësimit të hulumtimit tonë dhe të shmangies së përgjegjësive të menaxherëve të shkollave. Procesi i sigurimit të materialeve është ndarë në dy faza. Faza e parë përfshin kontaktin me drejtorët, zëvendës drejtorët, pedagogët dhe sekretarët e shkollave, nga të cilët kemi kërkuar dorëshkrime të mësimit të Gjuhës shqipe, si dhe qasje në ditarët e klasëve. Duke marrë parasysh që në shumë shkolla të zonave rurale një mësimit mbulon të gjitha orët e Gjuhës shqipe, kjo ka kufizuar mundësinë e përzgjedhjes së respondentëve në shumë raste. Në shkollat e zonave urbane është përzgjedhur mësimit më i ri në një shkollë dhe mësimit më i vjetër në shkollën tjetër, kështu ka vazhduar përzgjedhja e respondentëve.

Faza e dytë e hulumtimit ka përfshirë bashkëpunimin me mësimit të Gjuhës shqipe dhe ata të Programit fillor (mësuesit e klasëve), për të parë dhe analizuar praktikën e punës së tyre me nxënës për mësimit të normës së shkruar. Pyetësorët, të cilët i kemi përdorur për hulumtim, kanë ofruar informacion mbi përkushtimin e mësimit ndaj materialeve didaktike, si dhe praktikën e tyre të mësimit në përgjithësi.

Nga mësimit kemi kërkuar gjithashtu teste ose ese të nxënësve, të kontrolluara paraprakisht, për të vlerësuar performancën e mësimit gjatë punës me nxënës.

Secili kapitull përmban gjithashtu rezultatet e hulumtimit në forma tabelare ose grafike, të cilat do të shoqërohen me përfundime, rekomandime dhe bibliografinë.

Këto të dhëna do të ndihmojnë në përmbledhjen e gjetjeve dhe ofrimin e udhëzimeve për përmirësimin e praktikave të mësimit dhe përvetësimit të normës drejtshkrimore.

Fjalët kyçe: *gramatikat shkollore të shqipes, Gjuhë shqipe, kompetencë, mësimit, norma e shkruar.*

RESUME

The interest in the study of written Albanian began with the first grammar of foreign authors, such as Da Lece, who, in his book "*Grammatical Observations on the Albanian Language and Its Orthography*" (1716), addresses the written standard of Albanian and proposes corrections for printing errors. This development continued and was followed by other works such as "*Grammatical Rules of the Albanian Language*" by Francesco Rositi and the brochure "*Oro e permii abetare shqyp*" by the Bashkimi Society (Kastrati, 1955). The latter is the first to lay the foundations in the history of Albanian orthography, establishing rules for the use of the vowel "ë" in written Albanian. The work of these authors has created an important foundation for the formation of the Albanian standard.

After this theoretical development, it was deemed necessary to investigate the implementation of these rules and the performance of Albanian language teachers regarding spelling competence, considering this group of teachers as the main factor in transmitting this standard. Teachers are those who transmit spelling knowledge to students, and for this reason, it is important to assess how capable they are of mastering and applying these rules in practice, especially when working with students.

The philosophy upon which modern teaching methodologies are built, based on the idea that students learn best by doing, emphasizes the importance of the active engagement of students and teachers as partners in the learning process. The development of spelling competence is an ongoing process that requires regular practice and consistent reflection, where writing plays a key role. Writing is a powerful tool for strengthening spelling skills, as it encourages reflection and self-correction of mistakes. In this context, it is necessary to assess how capable teachers are of guiding students in mastering a correct and consistent norm.

After this theoretical development, we have deemed it necessary to investigate the implementation of these rules and the performance of Albanian language teachers concerning spelling competence, considering this group of teachers as the main factor in transmitting this standard. Teachers are the ones who transmit spelling knowledge to students, and for this reason, it is important to assess how

capable they are of mastering and applying these rules in practice, especially when working with students.

The philosophy upon which modern teaching methodologies are built, based on the idea that students learn best by doing, emphasizes the importance of the active engagement of students and teachers as partners in the learning process. The development of spelling competence is an ongoing process that requires regular practice and consistent reflection, where writing plays a key role. Writing is a powerful tool for strengthening spelling skills, as it encourages reflection and self-correction of mistakes. In this context, it is necessary to assess how capable teachers are of guiding students in mastering a correct and consistent norm.

Our work, titled "*The Competencies of Albanian Language Teachers in Pre-University Education Regarding the Written Standard*," consists of six chapters.

Chapter One provides a general introduction to the study topic, presenting the research problem, objectives, research questions, hypotheses, the importance of the research, and the fundamental concepts of the study. This chapter is an overview of the entire research work, placing the study in the context of the significance of spelling competence among Albanian language teachers and the process of teaching the written standard. Through this chapter, the direction of the research is clearly defined, with the aim of analyzing teachers' performance in mastering and using spelling rules, as well as the impact of teaching practices on the development of these skills in students.

Chapter Two is descriptive in nature and offers a historical overview of the development of Albanian school grammars from 1635 to 1912. This chapter highlights the contribution of both foreign and local authors in the creation of Albanian school grammars, starting with the Latin-Albanian Dictionary of Bardhi (1635) as one of the earliest sources of this kind.

In addition to the grammars of foreign authors, this chapter also emphasizes the role of Albanian national revivalists, who contributed to the development of Albanian school grammars. It includes their works that helped in the systematization and organization of the Albanian language, concluding the history of Albanian grammars with the contribution of Luigj Gurakuqi. His works are a natural continuation of these efforts, marking an important step in the development of the Albanian school grammar for high schools.

Chapter Three focuses on the treatment of the Albanian language as a subject in curricula and school textbooks during the period 1915-2020. In this chapter, the content and structure of the current school grammars used according to the curriculum (MASHT, 2011) are examined, as well as the space occupied by the written standard in Albanian language books and workbooks, emphasizing that they have a direct impact on the development of students' language skills. The inclusion of grammatical and orthographic rules in these textbooks helps in the formation of structured and stable knowledge of the Albanian language for students.

Chapter Four provides a detailed overview of teaching practices and how the standard written Albanian is learned and applied in pre-university education in Kosovo. The focus is on the methods and techniques used by teachers to help students master spelling rules and develop accurate and consistent knowledge of the Albanian language.

One of the most frequent and effective practices is considered to be essay writing as part of the grading process. The essay is seen as an important tool for developing writing skills and strengthening students' spelling competence. This chapter examines the organization of this activity, including aspects such as: the number of hours, learning objectives, assessment criteria, methods of correction, and the feedback provided by teachers to students, all of which are essential for reflecting upon and improving their writing skills.

Chapter Five analyzes the most common spelling violations made by Albanian language teachers, also examining the factors that influence the (non)mastery of the spelling standard. The focus is on identifying spelling errors that occur during the writing process and how these violations may be linked to a lack of knowledge of the Albanian spelling rules. Additionally, this chapter addresses the impact of other factors, specifically professional preparation, issues related to the Albanian language standard, and how these may contribute to the incomplete application of the spelling norm.

Chapter Six analyzes another important aspect, namely the self-efficacy of Albanian language teachers, particularly regarding the preparation of written tests (assessments). This section will reflect on how effective Albanian language teachers are in creating written tests through which

students' knowledge is assessed and whether teachers are capable of applying a well-founded and accurate methodology for evaluating writing skills, especially in stimulating critical thinking.

The corpus of this research includes 110 different schools in the Republic of Kosovo. The research covers all regions of Kosovo, and due to the nature of the study, the number of schools is not determined according to the representation of each area. The study includes 72 primary schools and 38 secondary schools. Among these, 38 schools are located in rural areas and 72 in urban areas.

Furthermore, 30 schools from the Prishtina Region, 9 from the Mitrovica Region, 20 from the Peja Region, 16 from the Prizren Region, 5 each from the Gjilan and Ferizaj Regions, and 25 schools from the Gjakova Region were included in the study.

Initially, we requested written permission from the municipal education directorates in order to facilitate our research and avoid responsibilities for school managers. The process of securing materials was divided into two phases. The first phase involved contacting the principals, vice principals, pedagogues, and school secretaries, from whom we requested lesson plans from Albanian language teachers, as well as access to class registers. Given that in many schools in rural areas, one teacher covers all Albanian language classes, this limited the possibility of selecting respondents in many cases. In schools in urban areas, the youngest teacher in one school and the oldest in another were selected, continuing this selection process for respondents.

The second phase of the research involved collaboration with Albanian language teachers and primary school teachers (classroom teachers) to observe and analyze their teaching practices with students regarding the learning of the written standard. The questionnaires we used for the research provided information on teachers' commitment to teaching materials, as well as their general teaching practices.

We also requested tests or essays from students, previously assessed, to evaluate the teachers' performance when working with students.

Each chapter also includes the research results in tabular or graphical forms, which will be accompanied by conclusions, recommendations, and the bibliography. These data will help summarize the findings and provide guidelines for improving teaching practices and the mastery of the spelling standard.

Keywords: *Albanian school grammars, Albanian language, competence, teachers, written standard.*